

Për:	Operatorë Ekonomik: "KOMTEL PROJECT ENGINEERING" SH.P.K. me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	10.09.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim, të datës: **08.09.2021**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **"KOMTEL PROJECT ENGINEERING" SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSOR PËR FERMERË ME PARTICIPIM 80 % - 20 %**, me Numër të prokurimit: **623-21-4135-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-036-1-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **"KOMTEL PROJECT ENGINEERING" SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSOR PËR FERMERË ME PARTICIPIM 80 % - 20 %**, me Numër të prokurimit: **623-21-4135-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-036-1-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **03.08.2021**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave, pika II. *Kurdo qe miratimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti Kontraktues do te beje publikimin e Njoftimit për korrigjim te gabimeve, duke përdorur formularin B54.*
- III. **Vërejtje:** Komuna do të bëjë korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara sipas Ligjit të Prokurimit Publik për **Pretendimet ankimore qe janë pjesërisht të bazuar.**
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: "KOMTEL PROJECT ENGINEERING" SH.P.K. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSOR PËR FERMERË ME PARTICIPIM 80 % - 20 %, me Numër të prokurimit: 623-21-4135-1-1-1, Numër i brendshëm: 623-21-036-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: 03.08.2021, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 08.09.2021, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Në pajtim me Nenin 108/A të LPP-së Paragrafi 3.1 Kërkesa për rishqyrtim paraqitet kundër njoftimit për kontratë më saktësisht dokumentet e tenderit dhe paramasës / specifikimit teknik të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues. Ne si Operator ekonomik referuar kriterëve të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë kemi bërë kërkesë për informacione shtesë për 3 pyetje kryesore për dy nga të cilat nuk kemi marrë përgjigje ndërsa një nga përgjigjet e pranuar ka qenë shumë e mangët, vijmë në përfundim se kjo dosje e tenderit nuk është në harmoni me LPP-në dhe legjislacionin sekondar për prokurimin publik.

Fillimisht, konform LIGJIT Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË

REPUBLIKËN E KOSOVËS Neni 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit, paragrafi 1. Gjatë përgatitjes së tenderit, çdo operator ekonomik mund të bëjë kërkesë me shkrim të autoriteti përkatës kontraktues për çfarëdo informate apo sqarim shtesë, dhe kjo kërkesë është bërë brenda afateve kohore të përcaktuara në DT për informacion shtesë lidhur me 3 pyetje për të cilat kemi menduar se janë të nevojshme për përgatitjen dhe dorëzimin e një tenderi të përgjegjshëm, ku për 2 nga të cilat nuk kemi marrë përgjigje nga Autoriteti kontraktues. Ky veprim i AK shkel nenin 53 paragrafi 5. Nëse autoriteti kontraktues konstaton se operatorët ekonomik nuk kanë nevojë për informatat e kërkuara, autoriteti kontraktues menjëherë do t'i njoftojë mbi refuzimin e kërkesës me shkrim operatorit përkatës ekonomik. Dhe paragrafi 6. Nëse autoriteti kontraktues konstaton se ndonjëra nga informatat e kërkuara sqaruese ose plotësuese e cila kërkohet nga operatorët ekonomik për kontraktim është e domosdoshme për ta, autoriteti kontraktues menjëherë dhe në të njëjtën kohë siguron informata me shkrim, përmes mjeteve më të shpejta të mundshme, të gjithë operatorëve ekonomik. AK në këtë rast ka bërë shkelje të nenit 53 të LPP duke na injoruar plotësisht 2 pyetjet e kërkesës tonë për informata shtesë. Neni 3 i RRUOPP-së i kërkon AK-së që AK gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit janë të obliguar të marrin masa të nevojshme për të siguruar trajtim të barabartë dhe jo- 5/7 diskriminim në mesin e Operatorëve Ekonomik. AK me vet faktin që nuk na ka shqyrtuar kërkesën tone për informata shtesë dhe ka vazhduar me procesin nënkupton se nuk po na trajton në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese. Përgjigja në kërkesa për informacion shtesë është e domosdoshme qoftë ajo positive apo negative, andaj AK po shkelë nenin 53 të LPP-së

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është pjesërisht i bazuar, pasi që kemi bërë një lëshim teknik lidhur me përgjigje për shkak të ngarkesës së madhe të punës, përgjigjja juaj e plotë do të kthehet përmes këtij vendimi pasi që janë të njëjta pretendimet edhe në Kërkesë për Rishqyrtim

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Pretendimi 2. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. **Kërkesa 1.** Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë (furnizim me mekanizëm bujqësore); Dëshmia 1 Lista e projekteve të kryera në lëmin e furnizimeve të natyrës së njëjtë (furnizim me mekanizëm bujqësore),...(Nëse kontratat janë të kontraktuara me subjekte private kombëtare e ndërkombëtare, atëherë ato duhet të dëshmohen me qarkullime bankare për atë kontratë - referencë - kontratës, bashkangjitur pagesën bankare).

Te dy formulimet si ne rastin e pare qe kërkohen "kontrata të natyrës së njëjtë (furnizim me mekanizëm bujqësore)" ashtu edhe te Dëshmia per kontrata me subjekte private qe kërkohet "bashkangjitur pagesën bankare" përfshire ketu edhe formulimin "furnizim me mekanizëm bujqësore" bie ndesh me nenin 69 te LPP-se dhe Interpretimeve Ligjore te dhëna nga KRPP përmes Website te "Pyetjet e Shpeshta". Te Neni 69 te LPP-se nga operatorët ekonomik kërkohen vetëm furnizimeve ne 3 vitet e shkuara dhe nuk ceket qe furnizimet te jene te "NJEJTA apo NGJAJSHME" por është formulim i përgjithshëm sepse është e rëndësishme te kjo kategori e prokurimit "FURNIZIME" te deshmohet liferimi i furnizimeve per nje aktivitet te caktuar ne menyre te duhur dhe konform kerkesave te projektit/tenderit.

Për me shume referojuni Nenin 69, Paragrafi "Autoriteti kontraktues mund të kërkojë listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë - sipas këtij neni nuk kërkohen pagesat e bëra nga blerësi privat, sepse një shumicë e bizneseve ushtrojnë

veprimtarine e vet me marreveshje bashkëpunimi; kontrata afatgjata, afate të pagesave, kompensime malli madje edhe pagesa me kesh, edhe pse liferimi i mallit për atë marreveshje është kryer në mënyre perfekte).

Kriteri i kontratave të realizuara "FURNIZMEVE" është e rregulluar edhe me RRUOPP, Nenin 26 se si duhet vepruar Autoriteti Kontraktues me rastin e përpilimit të dosjes së tenderit përkatësisht të Kapaciteti Teknik dhe Profesional, Pika a :

3. Aftësitë teknike dhe/ose profesionale	Në rast të kontratës për furnizim të produkteve: a. Vlera minimale në lidhje me furnizimet në 3 vitet e fundit b. Kërkesat minimale të mundësive teknike të OE	a. Një listë që liston furnizimet kryesore relevante të OE që specifikon: produktet e përfshira, shumën kontraktuale, datën dhe pranuesin / certifikata e pranimit b. Përshkrim i mundësive teknike të OE
--	--	---

Formulimi i duhur në mënyrë të përgjithshme sipas rregullave dhe dispozitave ligjore i mundëson të gjithë OE në treg të përmbushin kapacitetet minimale të furnizimeve që të arrijnë të plotësojnë kriterin e përzgjedhjes dhe pjesëmarrjen me të madhe të OE që është qëllimi i LPP-së nën 1 Qëllimi, ndërsa formulimi i juaj si : "Furnizime të njëjta", dhe formulimi i hapur diskriminuesi "kontrata për furnizim me mekanizëm bujqësor" e zvogëlon në tërësi pjesëmarrjen e OE dhe pjesëmarrjen e OE të caktuar të cilët kanë kapacitete të plota dhe ekupe profesionale për të kryer këto furnizime për këto aktivitete të prokurimit për shkak të këtij kriteri diskriminues dhe në kundërshtim me nenin 1 dhe 7 të LPP-së.

Kërkesë : që ky kriter për kontrata të njëjta (mekanizëm bujqësor) në kundërshtim me Nenin 69 të LPP-së, Nenin 26 të RRUOPP-së dhe posaçësisht me Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi të LPP-së të largohet nga lista e kriterëve dhe të përmirësohet në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të LPP-së, RRUOPP-së dhe Interpretimeve Ligjore të dhëna nga KRPP – furnizime kryesore...

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar

Sa i përket Pyetjeve & Përgjigjeve jeni bazuar te pyetja nr. 74 ku asnjë paragraf nuk ka ndalesa të kufizimit të kontratave të njëjta apo te ngjashme të cilat janë kërkesat të dosjes së tenderit bazuar në ligjin e prokurimit dhe Udhëzuesin.

Sa i përket natyrës së ngjashme qfar do të ishte e ngjashme në këtë procedurë?

Për këtë arsyeje ne si AK për të qene me të qarte kemi vendosur përshkrimin Kontrata të Njëjta, sepse tjera nuk ka.

Gjeni të bashkangjitur Pyetjen Nr. 74 nga Interpretimi i KRPP-së:

74. 26.06.2020 Kurdo që kërkohet në FDT të Dosjes së Tenderit dhe në Njoftim për Kontratë "Lista e kontratave të realizuara (përfunduara) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë", gjatë vlerësimit të tenderëve, a duhet të merret për bazë totali i vlerës së kontratës apo duhet të përpjesëtohet?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim:

Sa i përket dëshmime të kërkuara nga Autoritetet kontraktuese në FTD të Dosjes së tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në lidhje me Aftësitë teknike dhe/ose profesionale, paragrafi 4.2 i nenit 69 të këtij ligji përcakton:

4.2 listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënenëshkura nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë;

Në kuptim të nën-paragrafit 4.2 të nenit 69 të lart cituar, AK në rast se kërkon dëshminë - *Listën e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, (nga data e njoftimit për kontratë)* kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkua nga data e njoftimit për kontratë. Pra për bazë duhet të merret *periudha e përfundimit* jo e fillimit të kontratës. Për më shumë, kjo do të thotë se në këtë listë duhet të saktësohen të gjitha informatat e hijezuara në këtë nën-paragraf: *Llojin e shërbimeve, shumën e kontratës që nënkupton totalin e përgjithshëm të kontratës, datën dhe pranuesin.*

Si rrjedhojë, gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve në përputhje me dispozitën e lart cituar duhet të merret për bazë shuma totale e kontratës së specifikuar në listë dhe jo të përpjesëtohet.

Shembull:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën 3.000.000 euro kontrata kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Dëshmia dokumentare 1: Lista e kontratave kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin.

Në rast se kërkesa e kontratave të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë i referohet së bashku një totali prej 3,000,000 euro në tri vitet e fundit (2017, 2018, 2019) dhe operatori ekonomik ka realizuar (përfunduar) një kontratë tri vjeçare të shërbimeve kryesore në vitin 2017 në vlerë prej 3,000,000 euro (kontrata e cila ka filluar dy vite më herët), konsiderohet se OE ka përmbushur kërkesën minimale vetëm me atë kontratë. Kushti minimal është përmbushur duke prezantuar dëshminë Listën e kontratave të realizuara së bashku në total prej 3,000,000 euro në tri vite dhe nuk ka rëndësi se kontrata ka filluar dy vite më herët.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Lidhur me kërkesën tonë për informacione shtese të specifikave teknike më saktësisht pytjen tonë të datës 23.08.2021 se a kemi mundësi të ofertojmë edhe paisje me specifika ekuivalente për të cilat nuk kemi pranuar asnjë përgjigje po ju shtjellojmë dhe njëherë si ne vijim:

Secili pozicion/paisje e kërkuar në secilin nga Lot-ët e këtij aktiviteti të prokurimit ka përmasa fikse (gjatësi, gjerësi dhe peshë) që aludon në prodhues të vetëm. Në asnjë nga specifikat teknike të përcaktuara për secilin paisje nuk janë vendosur maksimumet dhe minimumet e kërkesave që lejojnë pjesmarrje më të gjerë të Operatorëve Ekonomik.

Neni 28. Specifikimet teknike 2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. Përndryshe në Paramaset e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues ka specifika teknike fikse, kjo le të kuptojë që i tere mekanizmi bujqësor është kërkuar bazuar në prodhues të veçantë, gjë që kufizon konkurrencën e hapur dhe krijon mundësi për ofertim për OE të caktuar në tregun tonë.

RRUOPP *"Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës së prokurimit publik."*

LOT 2. MBJELLESE MISRIT PNEUMATIKE 4 RENDSHE

Mbjellësja e kërkuar është e markës GUNGOR (e vetmja kompani që prodhon mbjellëse me 38 litra rezervuar)

Në specifikim kemi vendosur dimensionet fikse të cilat eliminojnë konkurrencën e hapur dhe ju japin përparësi prodhuesve të vetëm një modeli. Kërkojmë të vendosim maksimume dhe minimume të paisjes për specifika si peshë, gjatësia dhe gjerësia fizike e paisjes, përfshirë peshën e rezervuarit të farës dhe fertilizuesit. Në këtë rast janë hartuar specifikime teknike që favorizojnë një brend të vetëm ndërsa diskriminojnë më shumë operatorë ekonomik.

MBJELLESE DY RENDORE: Kërkojmë të vendosim minimum dhe maksimume sidomos për peshën dhe kapacitetin e rezervuarit. Konform Neni 28. Specifikimet teknike

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i bazuar, pasi që kemi bërë një lëshim teknik lidhur me përmendjen "Ekuivalent" në këtë Specifikacione, ndërsa sa i përket kufirit Minimal dhe Maksimal tek Dosja e Tenderit – Dokumenti Shtojca – Gjenerali të bashkëngjitur - **Përshkrimi i Çmimeve – me përmirësime**

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 4:

LOT 3. -Motokultivator 4.00-4.4 kë

Motokultivator 4.00-4.4 kw, keni precizuar vetëm motokultivator Motor Diesel.

- Kërkesa jonë është të na lejohet edhe neve si OE të ofertojmë motokultivatorë me benzinë, meqë në këtë rast diesel-i nuk ka të bëjë me performancën, efikasitetin apo funksionin e motokultivatorit por si një specifikë/kriter na ndalon neve si OE që të marrim pjesë apo të ofertojmë në këtë tender me produktet tona me benzinë (Produkte Evropiane me qendrueshmeri 100% me të madhe se produktet e Kines)

- Është kërkuar vetëm model 3+1 shpejtësi, kërkojmë të na lejohet të ofertojmë edhe me 2+1 meqë funksioni është tërësisht i njëjtë dhe shpejtësia e 2 mund të arrijë shpejtësinë e 3 të modelit (Kinez) ndërsa modeli që ne duam të ofertojmë është Evropian.

Prandaj konform nenit 7 të LPP-së kërkojmë që të trajtohem ne mënyrë të barabartë me të gjithë Operatorët tjerë Ekonomik.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 4:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar për të dy nënpikat.

Sa i përket Motorit Diesel nuk është asnjë shkelje ligjore apo diskriminim sepse Motorit Diesel mund të ofrojnë shumë prodhues, ndërsa arsya e përzgjedhjes është ekonomiciteti

Nen pika e dytë është pretendimi i ngjashme për shkak se nuk keni asnjë arsye të vetme nëse AK të marrim modelet të vjetra, sa i përket shpejtësive, vetëm me vetëm se ju nuk mund të ofertoni.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 5:

LOT 4. Motokultivatori 7.5 kw kërkohej motokultivator me specifika të brendit LABIN, shkelje e nenit 28 të LPP-së

Motokultivatori 7.5kw përveq të tjerash kërkohej të ketë "boshtin e shtytësës F1 30 me 3 shpejtësi dhe Boshtin e shtytësës së kardanit F1 30, me 2 shpejtësi. Një specifikë e tillë mund të plotësohet edhe nëse kërkohej që motokultivatori të mund të përdoret për Frezë , Kosë dhe për tërheqjen e rimorkios.

Prandaj kërkojmë të largohet ky kriter teresisht diskriminues neni 7 i LPP dhe të vendoset kërkesë relevante e drejtuar funksionimit "që kanë mundësinë e përdorimit edhe për tërheqjen e rimorkios" sipas RRUOPP-së neni 20 Specifikimet teknike 20.4 Specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca , si dhe Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

Kërkesa juaj është që ky motokultivator të ketë 6 shpejtësi (4+2) kërkojmë të lejohet një ekuivalencë në këtë kriter.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 5:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i bazuar, pasi që kemi bërë një lëshim teknik lidhur me përmendjen "Ekuivalent" në këtë Specifikacione, ndërsa sa i përket kufirit Minimal dhe Maksimal tek Dosja e Tenderit – Dokumenti Shtojca – Gjenerali të bashkangjitur - Përshkrimi i Çmimeve – **me përmirësim**

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 6:

Ne LOT 5. Kërkohet ROTO KOSA 135 – FARMERS, “FARMERS” është “brend” i cili është nën përfagesimin e një OE të vetëm në Kosovë dhe si e tillë kjo kërkesë shkel LPP neni 28 dhe RRUOPP neni 20.8 Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 6:

Ju sqarohet se ky pretendim i juaj është i bazuar, pasi që kemi bërë një lëshim teknik lidhur me përmendjen “Ekuivalent” në këtë Specifikacione, ndërsa sa i përket kufirit Minimal dhe Maksimal tek Dosja e Tenderit – Dokumenti Shtojca – Gjeni te bashkangjitur - **Përshkrimi i Çmimeve – me përmirësime**

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit